


RAPORTI I DËGJIMEVE BUXHETORE KAB 2027-2029



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR MË: 24.07.2026			
ALFETIA	NR. KLASIFIKIMIT	NR. LËNDËS	SHTOJCA
JEDINICA	BR. KLASIFIKACIONE	BR. PREDMETA	PROLOG
1	400/03	34708	



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Zyra e kryetarit të komunës

Datë:	24.07.2026
Për:	Z. Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit
Kopje:	Z. Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës Z. Mehreme Goliqi – Nënkyetare e Komunës Z. Latif Ramadani – Drejtor për Buxhet dhe Financa
Nga:	Zyra për Informim
Lënda:	Raporti i dëgjimeve publike lidhur me planifikimin e KAB për vitet 2027-2029

Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 paragrafi 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 datë 4 qershor 2008; neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit Nr. 110-78095, të datës 24.12.2021; Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 03/2020 për Transparencën në Komuna, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, Rregullores për Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-353-35739, të datës 30.06.2021 si dhe Planit të Veprimit për Transparencë në Komunë, me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, përfaqësuesit e Komunës, konkretisht nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, kanë mbajtur dëgjime publike për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029 me qytetarët e vendbanimeve të ndryshme të Lipjanit.

Përmbajtja

1. Vendim për themelimin e grupit punues për hartimin e planifikimit të projekt buxhetit 2027-2029..	4
2. Ecuria e procesit.....	5
3. Dëgjimi Buxhetor me Anëtarët e Kuvendit Komunal dhe Komitetet tjera.....	6
4. Dëgjimi Buxhetor me gratë dhe shoqatat e grave.....	7
5. Dëgjimi Buxhetor me organizatat e shoqërisë civile, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, shoqatat e të rinjve, klubet sportive, fermerët e Komunës së Lipjanit.....	8
6. Dëgjimi Buxhetor me qytetarët e Lipjanit dhe Kryetarët e këshillave të fshatrave.....	9
7. Dëgjimi Buxhetor me qytetarët e Grackës së Vjetër – komunitetet jo shumicë.....	10
8. Konkluzionet.....	11



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

**VENDIM
PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIFIKIMIT TË
PROJEKT BUXHETIT 2027-2029**

**Neni 1
Përbërja**

Me këtë Vendim themelohet grupi punues për hartimin e planifikimit të projekt buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2027-2029, në përbërje si vijon:

1. Latif Ramadani, Drejtor në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, Kryesues
2. Visar Kozhani, Zyrtar në Drejtoratin për Buxhet dhe Financa, anëtar,
3. Alban Bytyqi, Zyrtar financiar në QKMF, anëtar,
4. Behar Aliu, Zyrtar në Drejtoratin për Administratë, anëtar dhe
5. Ferdian Shala, Zyrtar në Zyren e Kryetarit të Komunës, anëtar.

**Neni 2
Detyrat e Grupit Punues**

Grupi punues ka për detyrë hartimin e projekt planifikimit të buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2027-2029 si dhe organizimin e degjimeve buxhetore në Komunën e Lipjanit. Grupi punues bënë vlerësimin e kërkesave të pranuar nga qytetarët dhe vendos cilat kërkesa pranohen dhe cilat refuzohen. Grupi punues duhet të hartojë planin e punës dhe të caktoj orarin e mbajtjes së degjimeve buxhetore duke mbajtur procesverbal dhe duke hartuar raport të punës së kryer të gjitha detyrat e hartimit të planifikimit të buxhetit për vitin 2027-2029 dhe organizimin e degjimeve buxhetore do të bëjë konform dispozitave të parapara ligjore që janë në fuqi. Po ashtu në fund të hartojë raportin nga degjimet buxhetore për ta dërguar në Kuvendin e Komunës.

Grupi punues duhet t'i ndjekë procedurat e degjimit publik sipas dispozitave ligjore përkatëse në fuqi në bashkëpunim me Zyrtaren përgjegjëse për konsultime publike të Komunës së Lipjanit.

**Neni 3
Hryja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

INr. 020/04-22345
Lipjan, më 18.05.2026

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti



Ecuria e Procesit

Zyrtari përgjegjës për menaxhimin e Platformës së Konsultimeve Publike dhe koordinimin e zbatimit të standardeve minimale të konsultimit publik në Komunën e Lipjanit, në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, ka publikuar në faqen zyrtare të Komunës së Lipjanit njoftimin për orarin e mbajtjes së dëgjimeve publike. Njoftimi është publikuar edhe në faqen zyrtare të Komunës së Lipjanit në Facebook shih linqet. ↓

Njoftimi për organizimin e dëgjimeve buxhetore KAB, 2027-2029:

<https://lipjan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/Njoftimi-per-degjimet-e-KAB.pdf>

<https://www.facebook.com/share/p/1Dpvz8nAYv/>

Po ashtu, në faqen zyrtare të Komunës, në rubrikën për konsultimet publike, është publikuar edhe draft projekt-buxheti, përmes të cilit qytetarët kanë pasur mundësi të paraqesin komentet dhe sugjerimet e tyre lidhur me planifikimin e buxhetit për vitet 2027–2029.

Shih linkun ➡ <https://lipjan.rks-gov.net/wp-content/uploads/Kornizes-Afatmesme-Buxhetore-2027-2029.pdf>

Njoftimi për organizimin e dëgjimeve publike është publikuar brenda afatit të përcaktuar ligjor, në përputhje me nenin 16 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna. Palët e interesuara janë njoftuar për datën, vendin dhe kohën e mbajtjes së takimeve publike. Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i shqyrtimeve publike ku ka qenë në diskutim publik projekt-buxheti për vitet 2027-2029.

Dëgjimi i parë publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitet 2027-2029 është mbajtur me anëtarët e Kuvendit Komunal, Komitetin për Politikë dhe Financa, Komitetin për Komunitete dhe komitetet e tjera. Procesi ka vazhduar me organizimin e takimeve me grupe të veçanta, përfshirë gratë dhe shoqatat e grave, organizatat e shoqërisë civile, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë dhe shoqatat e të rinjve, klubet sportive, si dhe fermerët e Komunës së Lipjanit. Ndërsa dëgjimet publike kanë vazhduar me banorët e qytetit të Lipjanit, kryetarët e këshillave të fshatrave dhe banorët e fshatit Grackë e Vjetër, me komunitetet jo-shumicë.

Drejtori për Buxhet dhe Financa z. Latif Ramadani, para të pranishmëve ka prezantuar projekt-buxhetin për vitet 2027–2029 dhe ka pranuar kërkesat e paraqitura gjatë këtyre takimeve. Ai ka inkurajuar qytetarët që të marrin pjesë në dëgjimet publike dhe të paraqesin kërkesat dhe propozimet e tyre për planifikimin e buxhetit për vitet e ardhshme.

Dëgjimi Buxhetor për Kornizën Afatmesme 2027-2029, me "Anëtarët e Kuvendit Komunal, Komitetin për Politikë dhe Financa, Komitetin për Komunitet si dhe Komitetet tjera".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me Kornizën Afatmesme 2027-2029	1. Kërkoj zëvendësimi i ndërtimit të rrugicave me ndërtimin e dy urave në Ruboc të Madh. 2. Rregullimi i ujësjellësit dhe kanalizimit në fshatra. 3. Ndarja e më shumë buxhetit për projektet që fuqizojnë gratë në biznes. 4. Ndarja e më shumë buxhetit për të rinjtë dhe të rejtat në fushën e teknologjisë. 5. Ndërtimi ose rikonstruimi i rrugës në fshatin Medvec deri në Magurë.	1. Kërkesa pranohet pjesërisht, pasi që përmes kodit me donator do të shikohet mundësia për përfshirjen e ndërtimit të dy urave në Ruboc të Madh. 2. Kërkesa pranohet, pasi që Komuna e Lipjanit ka paraparë investime në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit në disa vendbanime. 3. Kërkesa pranohet, Komuna e Lipjanit vazhdimisht ka ndarë mjete për mbështetjen e grave në biznes, në bashkëpunim me organizata vendore dhe ndërkombëtare. 4. Kërkesa pranohet, Komuna e Lipjanit vazhdimisht ka ndarë mjete nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për mbështetjen e organizatave që organizojnë trajnime në fushën e teknologjisë. 5. Kërkesa pranohet, pasi që Komuna e Lipjanit ka paraparë investime në rikonstruimin e rrugëve në Medvec dhe Magurë.	F M T 4 9 13	25.06.2026 Salla e Kuvendit Komunal Ora 13:30



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Anëtarët e Kuvendit Komunal, Komiteti për Politikë dhe Financa, Komiteti për Komunitet, si dhe komitetet tjera".

Dëgjimi Buxhetor për Kornizën Afatmesme 2027-2029, me "Gratë dhe shoqatat e grave".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me Kornizën Afatmesme 2027-2029	1. Kërkoj planifikimi i shtimit të çerdheve për vitet 2027–2029, me qëllim të lehtësimit të punësimit të grave. 2. A është planifikuar ndërtimi i ndonjë çerdheje në qytetin e Lipjanit? 3. A do të ketë trajnime apo do të ketë vetëm mbështetje financiare për fillimin e një biznesi? 4. A do të ketë përkrahje për startup-et, veçanërisht për aktivitetet që lidhen me prodhimin e produkteve tradicionale?	1. Kërkesa e pranuar, pasi që Komuna e Lipjanit ka paraparë ndërtimin e disa çerdheve për periudhën 2027–2029, në Magure, Banullë-Gillogovc, Janjevë, Dobrajë të Madhe dhe Kraishtë-Ribar i Madh. 2. Kërkesa e pranuar pjesërisht, pasi që Komuna e Lipjanit ka paraparë investime në ndërtimin e çerdheve në disa lokalitete, ndërsa në qytet do të shikohet mundësia përmes kodit me donator. 3. Kërkesa e pranuar pjesërisht, pasi që Komuna e Lipjanit vazhdimisht ka ofruar trajnime dhe mbështetje financiare për fillimin e një biznesi përmes kodit me donator. 4. Kërkesa e pranuar pjesërisht. Komuna e Lipjanit vazhdimisht ka mbështetur startup-et, varësisht nga fusha ku kanë aplikuar, përmes kodit me donator.	F M T 22 7 29	25.06.2026 Salla e Kuvendit Komunal Ora 14:30



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Gratë dhe shoqatat e grave".

Dëgjimi Buxhetor për Kornizën Afatmesme 2027-2029, me "Organizatat e shoqërisë civile, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, shoqatat e të rinjve, klubet sportive, fermerët e Komunës së Lipjanit".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me Kornizën Afatmesme 2027-2029	1. Çfarë po ndodh me subvencionet për klubet sportive dhe ku ka arritur procedura? 2. Si subvencionohen shkollat e futbollit dhe cilat janë kriteret? 3. A duhet të merret parasysh niveli i shpenzimeve apo numri i futbollistëve? 4. Ndarja e subvencioneve veçmas për sportin dhe veçmas për rininë. 5. Ndarja e mjeteve për mirëmbajtjen e terreneve sportive nëpër fshatra.	1. Sa u përket subvencioneve, aktualisht është duke u përgatitur thirrja publike, pasi që nuk kemi mundur ta shpallim më herët për shkak të mungesës së alokimit të buxhetit nga ana e ministrisë. 2. Shkollat subvencionohen përmes thirrjes publike për mbështetjen e klubeve sportive, shkollave të futbollit dhe OJQ-ve. 3. Sa i përket kriterëve, ato janë të përcaktuara përmes rregullores për subvencione. 4. Kërkesa pranohet, vazhdimisht bëhen thirrje publike të veçanta për organizatat e shoqërisë civile dhe të veçanta për klubet sportive. 5. Kërkesa pranohet, Komuna e Lipjanit, përmes kontratës për mirëmbajtje, ka paraparë edhe mirëmbajtjen e terreneve sportive në fshatra dhe në qytet.	F M T 4 17 21	25.06.2026 Salla e Kuvendit Komunal Ora 16:00




Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Organizatrat e shoqërisë civile, personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, shoqatat e të rinjve, klubet sportive dhe fermerët e Komunës së Lipjanit".

Dëgjimi Buxhetor për Kornizën Afatmesme 2027-2029, me "Qytetarët e Lipjanit-Kryetarët e Këshillave të Fshatrave".

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komenti për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me Kornizën Afatmesme 2027-2029	- Kërkoj asfaltimin e rrugicave në Hallaq të Madh. - Trajtimi i problemit me qentë endacakë.	- Kërkesa e pranuar, pasi që Komuna e Lipjanit ka paraparë asfaltimin e rrugicave në Hallaq të Madh, përmes projektit për asfaltimin e rrugicave në Hallaq të Madh, Mirenë dhe Kraishtë. - Kërkesa e pranuar, Komuna e Lipjanit, përmes kontratës për trajtimin e qenve endacakë, do t'i trajtojë të gjitha rastet ku paraqiten.	F M T 1 5 6	25.06.2026 Salla e Kuvendit Komunal Ora 17:00



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Qytetarët e Lipjanit".

Dëgjimi Buxhetor për Kornizën Afatmesme 2027-2029, me "Qytetarët e Grackës së Vjetër" – komunitetet jo shumicë.

Tema e Konsultimit	Kërkesat e qytetarëve	Komentet për pranimin dhe mospranimin e kërkesës	Pjesëmarrës	Data / vendi / ora
Raport i dëgjimeve publike lidhur me Kornizën Afatmesme 2027-2029	1. Të asfaltohet një rrugicë brenda fshatit? 2. Mirëmbajtja, riparimi ose zëvendësimi i ndriçimit publik.	1. Kërkesa e pranuar pasi që Komuna e Lipjanit ka paraparë asfaltimin dhe ndërtimin e rrugicave në disa fshatra përfshirë rrugicat në Hallaq të Madh, Mirenë, Kraishtë, Bujan, Topliqan, Grackë dhe Konjuh. 2. Kërkesa është pranuar, përmes kontratës për mirëmbajtje do të rregullohen dritat që janë të prishura.	F M T 1 2 3	25.06.2026 Shkolla fillore në Grackë të Vjetër Ora 18:00



Foto gjatë dëgjimit buxhetor me fokus grup "Qytetarët e Grackës së Vjetër".

Konkluzione

Organizimi i dëgjimeve buxhetore në kuadër të procesit të planifikimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore të Komunës së Lipjanit për periudhën 2027–2029 ka shërbyer si një mekanizëm i rëndësishëm për evidentimin e drejtpërdrejtë të nevojave, kërkesave dhe prioriteteve të qytetarëve. Përmes këtyre konsultimeve, qytetarët kanë paraqitur propozime dhe kërkesa konkrete në fusha të ndryshme të interesit publik, të cilat janë shqyrtuar në raport me mundësitë e planifikimit buxhetor të komunës.

Kërkesat e paraqitura gjatë dëgjimeve kanë përfshirë kryesisht investime në infrastrukturën lokale, ujësjellës dhe kanalizim, ndërtimin dhe asfaltimin e rrugëve dhe rrugicave, ndërtimin e urave, si dhe mirëmbajtjen e ndriçimit publik. Një pjesë e rëndësishme e kërkesave është fokusuar edhe në ndërtimin e çerdheve, mbështetjen e grave në biznes, të rinjve në fushën e teknologjisë, startup-eve, sportit dhe aktiviteteve rinore.


Nga gjithsej 18 kërkesa të paraqitura nga qytetarët, 15 kanë qenë kërkesa konkrete ndërsa 3 kanë qenë pyetje informative dhe procedurale. Nga 15 kërkesat konkrete, 11 janë pranuar plotësisht, që përbëjnë 73.33%, ndërsa 4 janë pranuar pjesërisht, që përbëjnë 26.67%. Në këtë proces të takimeve nuk ka pasur as një krekës të refuzuar. Në total 100% e kërkesave kanë marrë përgjigje pozitive ose të pjesshme nga Komuna e Lipjanit.

Ndër kërkesat e pranura janë investimet në ujësjellës dhe kanalizim, asfaltimi dhe rikonstruktimi i rrugëve dhe rrugicave, mirëmbajtja e ndriçimit publik dhe terreneve sportive, trajtimi i qenve endacakë, si dhe mbështetja për gratë në biznes, të rinjtë në teknologji dhe startup-et. Gjithashtu janë planifikuar investime në ndërtimin e çerdheve dhe mirëmbajtjen e terreneve sportive. Po ashtu janë dhënë sqarimet e nevojshme lidhur me pyetjet informative të cilat kanë qenë pjesë e këtyre takimeve buxhetore.

Këto kërkesa pasqyrojnë prioritetet e qytetarëve dhe janë marrë në konsideratë në procesin e planifikimit të Kornizës Afatmesme Buxhetore, në përputhje me mundësitë financiare të Komunës së Lipjanit.

Numri i pjesëmarrësve në dëgjimet buxhetore për planifikimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2027–2029 ishte si vijon: 40 burra dhe 32 gra, me gjithsej 72 pjesëmarrës në 5 takimet e zhvilluara në kuadër të këtij procesi. Pjesëmarrja e qytetarëve në këto takime ka mundësuar evidentimin e kërkesave nga fusha dhe komunitete të ndryshme, duke kontribuar në një proces më gjithëpërfshirës të planifikimit buxhetor.

Këtij raporti i janë bashkëngjitur edhe listat e pjesëmarrësve të dëgjimeve buxhetore.



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN



0 800 14 000 / 038 200 41 508



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



Rr. Shqipëria nr. 28/14000 Lipjan, Kosovë



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPIJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë: 25.06.2026

Vendi: Salla e Kuvendit

Lista e pjesëmarrësve në takim: Asambleja Komunale, Komitetit për Politikë e Financa,
Komitetit për Komunitete dhe Komitetet tjera

Nr.	Emri	Mbiemri	Nënshkrimi
1	Art	Krasniqi	
2	Behim	Krasniqi - YAH	
3	Zeja	Osmani - YHR	
4	Rino	Murati	
5	Shahidije	Dugagjina	
6	LIRI DON	HAJRI ZI	
7	HYRA	BYTYCI	
8	Besarta	Qadriaku	
9	AVRI	JASHARI	
10	Dona	Azemi	
11	LIRI	Ramaku	
12	Ferdion	Shek	
13	VISA	Kotari	
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë: 25.06.2026

Vendi: Salla e Kuvendit

Lista e pjesëmarrësve në takim: Gratë dhe shoqatat e Grave

Nr.	Emri	Mbiemri	Nënshkrimi
1	Donita	Bytyqi	Bytyqi
2	Agime	Budakova	Agime
3	Valmirë Haxhi	Marovci	Valmirë
4	Art	Krasniqi	Art
5	Bekim	Krasniqi - YAH	Bekim
6	Zoja	Osmani - YAH	Zoja
7	Mirjeta	Gashi	Mirjeta
8	Arbnora	Marerci	Arbnora
9	Ganimete	Gashi	Ganimete
10	Arbnora Dedushi	Dedushi	Arbnora
11	Bearta	Qadrati	Bearta
12	AVNI	JASHARI	AVNI
13	Artinesa	Karpuzi	Artinesa
14	Ajme	Vitija	Ajme
15	Bejuna Haxhi	Vershele	Bejuna
16	Dhehri de Jona Haxhi	Lipjan	Dhehri
17	Arta Krasniqi	Lipjan	Arta
18	Saranda Krasniqi	Lipjan	Saranda
19	Ajlana Gjencaj	Lipjan	Ajlana
20	Valon Placeli	Lipjan	Valon



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPIJANI
OPŠTINA LIPIJAN
MUNICIPALITY OF LIPIJAN

Datë: 25.06.2026

Vendi: Salla e Kuvendit

Lista e pjesëmarrësve në takim: Gratë dhe shoqatat e Grave

Nr.	Emri	Mbiemri	Nënshkrimi
1	Golom q	Hajdini	
2	Arbnora	Gashi	
3	Mirandë	Bytyqi	
4	Antigone	Krasniqi	
5	Levnore	Azemi - Shagiri	
6	Ferdion	Saka	
7	Masa	Hajdini	
8	Mehreme	Golipi	
9	Latif	Pamardani	
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPIJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë: 25.06.2026

Vendi: Salla e Kuvendit

Lista e pjesëmarrësve në takim: Organizatat e Shoqërisë Civile, Personat me aftësi të kufizuara, të rinjtë, Shoqatat e të rinjve, Klubet Sportive, Fermerët e Komunës së Lipjanit

Nr.	Emri	Mbiemri	Nënshkrimi
1	BGKIM	KRASNIQI - YAHIR	
2	Zeja	Osmani - YAHIR	
3	IPADIL	AHMETI	
4	Enis	Jashanica	
5	ASTRIT	BUDIT	
6	Gjerasa	TEXPESZ - LYC	
7	Vjosa	Gashi - POLIS	
8	Serdar	Jasholli -	
9	URANVERI	DERI	
10	Fazil Hrasniqi		
11	Kranjica	Kranjici	
12	Bandhyl G	Gashi	
13	Anon	BENELI	
14	Enbrit	Jashari	
15	Belum	ZHURIN	
16	Art	Krasniqi	
17	Valmire	Malovski	
18	Visar	HASHANI	
19	Jerion	SHUK	
20	Burim	REUSTEMI	
21	Morgjim	ORUÇI	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPIJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë: 25.06.2026

Vendi: Salla e Kuvendit

Lista e pjesëmarrësve në takim: Kryetarët e Këshillave të Fshatrave

Nr.	Emri	Mbiemri	Nënshkrimi
1	AGRON	ZEQIRI-HALLA	
2	Art	Krasniqi	
3	BGKM	KRASNIQI YAHIR	
4	Velmir	Haserici	
5	Ferdian	Shala	
6	Enver	Pomerani	
7			
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë: 25.06.2026

Vendi: Shkolla Filllore në Grackë të Vjetër

Lista e pjesëmarrësve në takim: Qytetarët e Grackës së Vjetër (Komunitetet jo shumicë)

Nr.	Emri	Mbiemri	Nënshkrimi
1	Zoran Cirnovic	Cirnovic	
2	Mehreme	Goligj	
3	Nosen	Bytyqi	
4			
5			
6			
7			
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			